



## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri i NSH-së</b>	NSHB ELAN ("Ndermarrja")
<b>Emri i Ndërmarrjes së Re</b>	<b>Ndërmarrja e Re Gllavotin SH.P.K.</b>
<b>Lokacioni</b>	Fshati Gllavotin– Komuna e Vushtrrisë
<b>Biznesi/Spektori</b>	Agrikulturë
<b>Produktet</b>	Ndërmarrja kultivon produkte bujqësore për industrinë e përpunimit të ushqimit. Viteve të fundit ka prodhuar grurë, misër, dhe tërshërë. E mbjella kryesore e saj momentalisht është gruri. Në këtë tokë do të kishte mundësi kultivimi për prodhimin e grurit dhe misrit apo edhe ndërtimi i ndonjë objekti me nevojë.
<b>Tregu</b>	Në Kosovë momentalisht operojnë disa fabrika për përpunimin e ushqimit. Klientët kryesorë të ndërmarrjes viteve të fundit kanë qenë fabrika e birrës në Pejë si dhe disa mullinj të ndryshëm të miellit. Klientët kryesorë momentalisht janë NSh dhe kompanitë e ndryshme private.
<b>Konkurrenca</b>	Një numër i madh i prodhimeve bujqësore janë importuar pas vitit 1999 në Kosovë. Prandaj, ekziston një potencial i madh për zëvendësimin e importit. Konkurrenca përbrenda Kosovës për momentin është e kufizuar por pritet të rritet sa ma shumë që Ndërmarrjet Shoqërore të privatizohen apo të ristrukturohen me qëllim të rritjes së prodhimit.
<b>Punëtorët</b>	Ndërmarrja ka 20 punëtorë të punësuar.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	Toka e Ndërmarrjes së Re Gllavotin SHPK e regjistruar ne Cerifikaten mbi te drejtat e pronës se paluajtshme nr.-70202017-00064 përfshinë një sipërfaqe prej 10ha 4ari 92m <sup>2</sup> (100492m <sup>2</sup> ). Nuk ka objekte të transferuara në Ndërmarrjen e Re. Gjate vizitës sonë në terren parcelat shfrytëzohen nga ana e fshatarëve, pa marrëveshje paraprake me Menaxhmentin e Ndërmarrjes.
<b>Detyrimet që do të barten</b>	Në Ndër. e Re do të barten vetëm disa detyrime të kufizuara, si dhe kontrata me furnizuesit dhe konsumatorët që janë të domosdoshme për veprimet në vazhdim e sipër të Ndër. së Re.

**Foto e  
Ndërmarrjes së  
Re.**



**Informata**

Departamenti i Shitjes  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255  
Fax: +381 (0) 38 500 400  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

**Dokumentet e  
Ofertimit**

Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rruga: Ilir Konushevci Nr:8  
10000 Prishtinë, Kosovë

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes i paraqitur në këto të dhëna nuk është i garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënien e informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të mirren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>